



SOS FSHATRAT  
E FËMIJËVE  
KOSOVË

## FTESE PER OFERTE

*Fondacioni SOS Fshatrat e Fëmijëve është organizatë joqeveritare e përkujdesjes sociale e dedikuar për përkrahjen e fëmijëve të braktisur dhe në nevojë, pa marrë parasysh etninë, kombësinë dhe besimin fetar.*

SOS Fshatrat e Fëmijëve duke përfshirë të gjithë projektet në kuadër të organizatës, fton ofertuesit e specializuara dhe të interesuara për sallë të mjaftueshme, për realizimin e trajnimeve, seminareve, konferencave si dhe për aktivitete tjera. Salla do të përdoret për të përmbushur aktivitetet e planifikuara gjatë vitit që do të ofrojnë mundësi për zhvillim profesional të punonjësve, shkëmbimin e përvojave me partnerë dhe bashkëpunëtorë, zgjerimin e partneriteteve dhe promovimin e punës së organizatës.

### **Me këtë rast ju bëjmë Ftesë për Ofertë sipas specifikacionit në vijim:**

#### **LOT 1 Sallë Trajnimi**

- Sallë trajnimi e cila ka kapacitet për 20-30 persona
- Salla të jetë e përshtatshme për punë në grupe, session plenar apo format tjetër
- Salla të ketë kushte për punë sa i përket ndriçimit, ajrosjes, pastërtisë dhe qetësisë;
- Ofrimi I ujit (2 shishe të vogla) për pjesëmarrës gjatë trajnimit
- Ofrimi I kafes (2 kafe) për pjesëmarrës gjatë pauzave
- Dreka për pjesëmarrës (ju lutem të bashkëngjisni menynë: Supë, sallatë, pjata kryesore, desert dhe një shishe e vogël ujë).

#### **LOT 2 Sallë Konference**

- Sallë për konferencë e cila ka kapacitet për 50-150 persona
- Salla të jetë e përshtatshme për konferencë, sesion plenar, mbrëmje humanitare apo evente tjera
- Salla të ketë kushte për punë sa i përket ndriçimit, ajrosjes, pastërtisë dhe qetësisë;
- Ofrimi I ujit (2 shishe të vogla) për pjesëmarrës
- Ofrimi I kafes (2 kafe) për pjesëmarrës
- Dreka/ Darka për pjesëmarrës (ju lutem të bashkëngjisni menynë: Supë, sallatë, pjata kryesore, desert dhe një shishe e vogël ujë).
- **Salla duhet të jetë në dispozicion përafërsisht 2 deri 4 herë në vit**

**E gjithë hapësira e ofruar duhet të jetë në përputhje me respektimin e masave sipas Manualit për mbrojtje nga COVID-19 nga Qeveria e Kosovës.**

**Salla duhet të jetë e pajisur me:**

- Internet të shpejtë;
- Projektor;
- Tabelë për mbajtjen e letrave (flipchart)
- Mundësi për printim (e preferuar)

**Sallat duhet të jenë me lokacion në Prishtinë dhe jo më larg se 10 km nga Prishtina**

**Dokumentet e nevojshme:**

1. Qertifikata e regjistrimit të biznesit/ NUI
2. Qmimet e kuotuar në euro pa tvsh
3. Oferta financiare e ndarë me cmime për: sallë, ujë, kafe dhe drekë/ darkë
4. Oferta financiare e nënshkruar ose me llogo zyrtare

**Kriteret për përzgjedhjen e ofertës më të mirë do të jenë si në vijim:**

1. Përmbushja e specifikacionit sipas Ftesës për Ofertë
2. Pas plotësimit të kriterëve -Çmimi më i lirë

Vlefshmëria e Ofertës duhet të jetë 30 ditë nga data e mbylljes së Ftesës për Ofertë.

Ofertuesi i përzgjedhur, para nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës dhe pronari nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe vërtetimin tatimor

Ju mund të ofertoni për një LOT ose për të dy LOT- et, duke i dërguar ofertat ndarazi të emëruar Lot 1 ose Lot 2 sipas Lot-it përkatës

Ofertat tuaja mund t'i dërgoni deri me datën: **19.09.2022** në email adresën:

[procurement1@soskosova.org](mailto:procurement1@soskosova.org)